

STATUT I SHOQERISE

RED TAXI

KAPITULLI I EMERTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHEZGJATJA

Neni 1- Forma

Sot me date 08/09/2025 krijohet statuti si me poshte vijon:

Shoqeria tregtare **"RED TAXI"** (me poshte shenuar "shoqeria"), krijohet ne formen e nje shoqerie tregtare me pergjegjesi te kufizuar. Veprimtaria e saj rregullohet nga ky Statut, Akti i Themelimit dhe legjislacioni shqiptar ne fuqi.

Akti i themelimit dhe Statuti jane ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe çdo çeshtje e paparashikuar shprehimisht ne to, rregullohet sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi.

Neni 2-Emertimi

Shoqeria emertohet **"RED TAXI"**. Emertimi i shoqerise mund te shkruhet me shkronja te medha ose te vogla.

Neni 3-Selia

Shoqëria e ka selinë ne Qytetin e Fierit , ne adresen **Lagja 8 Shkurti,Fier ,nr pasurie 2/355-N9 zn kadastrale 8533,Fier .**

Adresa dytesore:

- 1- Lagja 8 Shkurti,Fier ,nr pasurie 2/355-N9 zn kadastrale 8533,Fier,Automjeti me Targa AB557UX.**
- 2- Lagja 8 Shkurti,Fier ,nr pasurie 2/355-N9 zn kadastrale 8533,Fier.Automjeti me Targa AB110PC .**


Përveç veprimtarisë në nivel lokal, shoqëria ka të drejtën e krijimit dhe mbylljes së filialeve, agjencive dhe zyrave të përfaqësimit brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Selia mund të transferohet në çdo vend tjetër brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, me një vendim të Ortakeve te kesaj shoqerie.

Shoqeria sipas parashikimeve te ketij statuti dhe legjislacionit ne fuqi, mund te hape si ne Shqiperi dhe jashte saj, qendra, perfaqesi, filiale, dege dhe shoqeri te tjera.

Neni 4- Kohezgjatja

Kohezgjatja e aktivitetit te shoqerise do te jete pa afat, duke filluar prej dates se rregjistrimit te saj ne Rregjistrin e Shoqerive Tregtare prane Qendes Kombetare te Rregjistrimit.Ky afat mund te ndryshohet nje ose me shume here, me vendim te asamblese se ortakeve.



Neni 5- Objekti i veprimtarise

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë **"RED TAXI"** do të shtrihet në këto fusha veprimi:

Shërbime në fushën e transportit të udhëtareve. Shërbime aksi për publikun si brenda territorit të Shqipërisë dhe jashtë saj. Transporti urban dhe interurban në funksion të shërbimit Taxi të udhëtarëve, në përputhje me çdo ligj të zbatueshëm dhe rregulloreve të fushës përkatëse .Tregti dhe dhënie me qira e automjeteve. Çdo veprimtari jetër ekonomike që do të konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme për realizmin e qëllimit të Shoqërisë e që nuk bie në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Neni 6- Përgjegjesia

Shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet e marra për qëllime që nuk përputhen me ato të percaktuara nga Statuti dhe Akti i Themelimit. Shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet e marra nga ortakët në emrin e tyre personal ndaj personave fizike, juridike, privat ose publik, brenda ose jashtë shtetit.

K A P I T U L L I II

KAPITALI I RREGJISTRUAR, KONTRIBUTET, NDARJA E KUOTAVE TE KAPITALIT

Neni 7- Kapitali I Rregjistruar

Kapitali është fiksuar në lek **100 000 (njqind mijë)** leke. I ndare në 1 (një) kuote në zotërim të ortakut themelues si më poshtë.

1. **RAMAZAN MYRTAJ** 1 (një) kuote me vlerë 100,000 (njëqind mijë) leke

Neni 8- Kuotat e Kapitalit të Rregjistruar

Kuotat e pjesëmarrjes janë në zotërim të :

1. **RAMAZAN MYRTAJ** , dhe përqindja e pjesëmarrjes **100%.**

KAPITULLI III

ASAMBLEJA, ADMINISTRIMI, KONTROLI

Neni 9- Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme

Administratorët thërrasin Asamblenë e Përgjithshme dhe, me kërkesën e ortakëve sipas nenit 83 dhe 84 të Ligjit, do të procedojnë me thirrjen e Asamblesë së Përgjithshme.

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi të dërguar me postë ose postë elektronike (email) drejtuar çdo ortakut përfshirë edhe përfaqësuesin e kuotave në zotërim të përbashkët. Njoftimi duhet të kryhet të paktën shtatë Ditë të Plota



përpara datës së caktuar për mbledhjen. Secilit ortak, së bashku me njoftimin për mbledhjen, i dërgohet edhe numri PIN për të mundësuar pjesëmarrjen dhe votimin elektronik në mbledhje.

Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme janë të pavlefshme në rast moskryerje të paqëllimshme së njoftimit apo mos-marrjes së njoftimit të mbledhjes nga personat të cilët kanë të drejtë të marrin këtë njoftim, me përjashtim të rastit kur shoqëria provon se personi i ka dhënë shoqërisë një adresë të pasaktë.

Neni 10- Administrimi

Shoqëria administrohet nga një ose disa administrator, qofshin keta dhe jo ortak, të cilët emerohen ose shkarkohen nga Asambleja e zakonshme. Administratori/et qëndrojnë në postin e tyre për pesë vjet financiare, me mundësi për të rizgjedhur.

Administratori/et kanë të gjitha kompetencat për të vepruar në mardhenie me të tretet, në interes të shoqërisë dhe në emër të saj, në të gjitha rrethanat që kanë lidhje me objektin e Shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji apo statuti ja jep Asamblese së Ortakeve.

Administrator i shoqërisë është Z. **RAMAZAN MYRTAJ** për një afat 5 (pesë) vjeçar. Ajo do të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme për rregjistrimin e shoqërisë në Qendren Kombëtare të Rregjistrimit (QKR).

Të gjitha shpenzimet që do të kryen deri në rregjistrimin e shoqërisë si person juridik do të përfshihen në bilancin e shoqërisë.

Neni 11- Ekspertët Kontabel të Autorizuar.

Shoqëria do të kontrollohet nga një ose disa eksperte kontabel të autorizuar të zgjedhur nga lista e Institutit të Eksperteve Kontabel të Autorizuar. Në caktimin e eksperteve kontabel të autorizuar mbahen parasysh përjashtimet dhe papajtushmeritë e percaktuara nga ligji "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Eksperti/et kontabel të autorizuar emerohen nga asambleja e përgjithshme, në afatet e parashikuara nga ligji, me të drejtë rizgjedhje në kushtet e marrjes së vendimeve që kërkojnë një shumicë të zakonshme.

Detyrimet dhe të drejtat e Eksperteve Kontabel të Autorizuar të shoqërisë janë ato të parashikuara nga ligji "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare". Raportet që ata përgatisin depozitohen në seline të shoqërisë, në afatet e parashikuara nga ligji.

KAPITULLI IV VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPERNDARJA E FITIMEVE

Neni 12- Viti financiar dhe bilanci vjetor.

Viti financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 dhjetor.



Viti i pare financiar fillon ne daten e regjistrimit te Shoqerise ne Rregjistrin Tregtar, prane Qendes Kombetare te Rregjistrimit, dhe perfundon ne 31 dhjetor te te njejtut vit.

Pasqyrat financiare,raporti i administrimit dhe raporti i ekspertit/ve kontabel te autorizuar miratohen nga asambleja e pergjithshme ne kushtet e marrjes se vendimeve qe kerkojne nje shumice te zakonshme.

Miratimi i dokumentave qe lidhen me vitin financiar duhet te behet brenda 6 (gjashte) muajve qe nga fundi i vitit financiar.

Neni 13- Dividendët

Pas plotësimit të parashikimeve të nenit 77 të Ligjit, shoqëria me shumicë të kualifikuar të votave së Asamblesë së Përgjithshme mund të deklarojë shpërndarjen e dividendëve nëpërputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që lidhen me kuotat, të gjithë dividendët deklarohen dhe paguhet në përputhje me shumën e paguara për kuotat për të cilët paguhet dividendi. Të gjithë dividendët pjesëtohen dhe paguhet në përpjesëtim të drejtë me shumën e paguara për kuotat, pjesës ose pjesëve të periudhës për të cilën paguhetdividendi; në rast se kuota emetohet me kushtin e përfitimit të dividendit nga një datë ecaktuar, dividendi do të paguhet në përputhje me këtë kusht.

Asnjë dividend ose pagesë në para që lidhet me një kuota nuk do të mbartë interesa ndajshoqërisë nëse nuk parashikohet nga të drejtat që lidhen me kuotën.

Çdo dividend që nuk është kërkuar të paguhet brenda dymbëdhjetë vjetëve nga data ematurimit, në rast se vendoset me shumicë të kualifikuar votash nga Asambleja ePërgjithshme, do të përfitohet nga shoqëria e cila nuk do të jetë më e detyruar që ta paguajë atë.

Neni 14- Kalimi i Fitimeve në Kapitalin Themeltar

Administratorët, pas vendimit të marrë nga Asambleja e Përgjithshme me shumicë të kualifikuar votash dhe duke pasur parasysh parimet e përcaktuara në nenin 14 të Ligjit,mund të vendosin të kalojnë në kapitalin themeltar të shoqërisë fitimet e pashpërndara të cilat nuk do të përdoren për të paguar dividendë preferencialë apo shuma të tjera të parashikuara për rezervat e kapitalit të shoqërisë.

KAPITULLI I V SHPERNDARJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE

Neni 15- Prishja, Likujdimi

Perjashtuar rastin e nje prishje me vendim gjyqi e parashikuar nga ligji, shoqeria mund te priset ne çdo kohe, me vendimin e marrë me shumicën e kualifikuar së votave të Asamblesë së Përgjithshme.

Perveç rastit te bashkimit ose te ndarjes, prishja e shoqerise per cfardo shkak qofte sjell likujdimin e saj. Likujdimi kryet nga nje ose disa likujdatore te emeruar nga Asambleja, te cilet kryejne kete detyre ne perputhje statutin e shoqerise, ligjin "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" dhe kerkesat e tjera ligjore.

Likujdatori perfaqeson shoqerine. Ai ka kompetenca te plota per te shitur aktivet e shoqerise, per te shlyer kreditorët dhe per te shperndare mbetjen e disponushme ne perpjestim me pjeset e ortakeve ne kapitalin e rregjistruar.
Me perfundimin e procedures se likujdimit te Shoqerise, Asambleja do te vendose, me vendimin e marrë me shumicën e kualifikuar së votave, mbi bilancin financiar perfundimtar mbi vlefshmerine e punes se kryer nga likujduesit dhe mbi perfundimin e procesit te likujdimit.

Neni 16- Transformimi i Shoqerise.

Shoqeria mund te ndyshoje formen e saj ligjore nepermjet shnderrimit, ne perputhje me kerkesat e nenit 228 te ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", me vendimin të Asamblesë së Përgjithshme te marrë me shumicën e kualifikuar së votave.

Neni 17- Shpenzimet.

Te gjitha shpenzimet e kryera perpara firmosjes se statutit dhe ato midis dates se firmosjes se statutit e rregjistrimit te shoqerise ne rregjistrin tregetar, jane shpenzime qe do perballohen nga shoqeria.

Neni 18- Te tjera

Ky akt themelimi u redaktua ne 4 kopje me permbajtje dhe vlere te njejta juridike ne gjuhen shqipe dhe u miratua nen per nen nga aksioneri themelues dhe u nenshkrua ne cdo flete me emer mbiemer dhe nenshkrim me vullnet te lire

ORTAKU THEMELUES

RAMAZAN MYRTAJ

